



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr. 03-326**  
**17.10.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 51, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-3355/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3637/7 datë 17.10.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në vazhdimin e parë të seancës së 32-të mbajtur më 16.10.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TELEVISIONI PLUS SHPK Kumanovë, për shkeljen e kryer të nenit 51, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që radiodifuzeri në kuadër të shërbimit programor televiziv, transmetuar më 10 gusht 2023, nuk ka ofruar informacione që duhet t'i vihet në dispozicion përdoruesve.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3355/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TELEVISIONI PLUS SHPK Kumanovë, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV.

3. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) është kompetente të kryej mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara nga Ligji për Media, LSHMAAV dhe dispozitave miratuar në bazë të Ligjit.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer shkelja e dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar në lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 51, paragrafi 1 nga LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale duhet përdoruesve të tyre t'u mundësojnë qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë, dhe të vazhdueshme së paku për të dhënat në vijim: emrin e ofruesit (dhënësit) të shërbimit mediatik audio ose adivuzual, gjegjësisht emrin, shenjën mbrojtëse ose shkurtesën e shenjës identifikuese personale (avizo, logon dhe të ngjajshme); adresën e selisë të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual; të dhënat për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio dhe audiovizual (numër telefoni, adresë e-maili dhe/ose ueb-faqes, personi për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundshme dhe të trupit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 1 shtator 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TELEVISIONI PLUS SHPK Kumanovë, transmetura më 10 gusht 2023, në nivel lokal, nga ku konstatoi shkelje të nenit 51, paragrafi (1) nga LSHMAAV. Gjegjësisht nga mbikëqyrja u konstatua se më 10 gusht 2023, SHTR

TELEVISIONI PLUS SHPK Kumanovë, nuk ka siguruar informacion që duhet t'u vihen në dispozicion përdoruesve, gjegjësisht nuk u mundësoi qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme së paku për të dhënat në vijim: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual; adresë të selisë për ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual; të dhënat për kontakt (numër telefoni, adresë e-maili dhe ose/ të ueb-faqes; personi për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për trupin rregullator kompetent.

Shkelja nga paragrafi (1) i këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative me ark.nr.10-3355/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi me Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TELEVISIONI PLUS SHPK Kumanovë më 06.09.2023, dërgoi Shkresë me ark.nr.10-3355/2 datë 06.09.2023, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me ark.nr.10-3355/1 datë 01.09.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e radiodifuzerit me datë 11.09.2023. Në afatin e parashikuar, TELEVISIONI PLUS SHPK Kumanovë, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 16.09.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi SHTR TELEVISIONI PLUS SHPK Kumanovë t'i shqipton masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3355/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3637/7 datë 17.10.2023, për konstatim të mos respektimit të dispozitave nga LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 16.10.2023, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron SHTR TELEVISIONI PLUS SHPK Kumanovë dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV. Pas mbarimit të afatit, përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3355/1 datë 01.09.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.